



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË**  
**KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË EKONOMISË**

Nr. 24 Prot

Datë, 27.04.2020

**VENDIM**  
**Nr.6, datë 27.04.2020**  
**PËR**

**SHTYRJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES  
TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E  
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E  
EKONOMISË NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në zbatim të nenit 18, të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 59, datë 11.02.2020 “Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë; Urdhërit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 99, datë 26.03.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin Nr. 8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”; referuar Vendimit të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Ekonomisë Nr. 2, datë 25.03.2020 “Për hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përherëshme në Njesisë Kryesore në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë”, Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Ekonomisë:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë shtyrjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përherëshme në Njesisë Kryesore në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve datën 06.05.2020, deri në datën 10.05.2020, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.  
Kërkesa për kandidim nga personat e interesuar depozitohet nga kandidati pranë Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Ekonomisë, salla A 206, kati i dytë në Fakultetin e Ekonomisë
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht pranë Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Ekonomisë. Pas regjistrimit, kandidati pajiset me vërtetimin e regjistrimit si kandidat nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Ekonomisë.
4. Vendimi afishohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Ekonomisë, si dhe publikohet në faqen web [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al).
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit:**  
**Grigor Dede**

**Anëtarët:**  
**Ilira Pulaj**  
**Desantila Ahmeti**